



2025 MARS

Mbrojtja në një muaj





DEKLARATA E PËRBASHKËT SHQIPËRI, KROACI, KOSOVË

Në Tiranë u nënshkrua “Deklarata e Përbashkët e Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes” ndërmjet Shqipërisë, Kroacisë dhe Republikës së Kosovës. Dokumenti u firmos nga ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Pirro Vengu, zëvendëskryeministri dhe ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, z. Ivan Anušić, dhe ministri i Mbrojtjes së Kosovës, z. Ejup Maqedonci.

★★★★★

mod.gov.al

MM



BAZA AJRORE E KUÇOVËS

Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, inspektuan Bazën Ajrore të Kuçovës. Ministri Vengu e informoi Kryeministrin rreth investimeve të realizuara dhe bëri me dije se skuadrilja e dronëve luftarakë është rritur dhe është plotësisht operacionale, duke mundësuar fluturimet edhe natën jo vetëm për qëllime sigurie por edhe për misione civile.

★★★★★

mod.gov.al

MM

GJENERALËT E RINJ TË FA

Forcave të Armatosura u shtohen edhe gjashtë ushtarakë me grada të larta. Me dekret të presidentit të Republikës, njëherësh komandant i Përgjithshëm i FA dhe me propozim të ministrit të Mbrojtjes, gjeneral brigade Ferdinand Dimo dhe Petrit Çuni tashmë do të mbajnë gradën gjeneralmajor. Kundëradmiral Adnand Agastra do të mbajë gradën nënadmiraal, ndërsa kolonelët Ardian Lilo, Vehbiye Kuti dhe Hamdi Doda do të mbajnë gradën madhore gjeneral brigade.

★★★★★



TAKIM ME MINISTRIN E MBROJTJES SË KOSOVËS

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një takim me homologun e tij nga Kosova, Ejup Maqedonci. Në qendër të diskutimeve ishte forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve. Në kushtet e një mjedisi të brishtë sigurie, të dy ministrat theksuan rëndësinë e konsultimeve të përbashkëta, duke i cilësuar ato si një përparësi strategjike. ★★★★★

A photograph of two men in dark suits shaking hands. The man on the left has dark hair and a beard, while the man on the right has short dark hair and glasses. They are standing in front of a backdrop featuring the flag of Slovakia on the left and the flag of Albania on the right. In the background, there is a faint logo of the Ministry of Defense of Albania and the text 'MINISTRIA E MBROJTJES'.

MINISTRI SLOVAK NË TIRANË

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, priti në një takim, në Tiranë, zv.kryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes së Sllovakisë, Robert Kalinák. Dy ministrat diskutuan rreth objektivave të mbrojtjes kolektive të Aleancës, sfidat e sigurisë dhendryshimet e rëndësishme në arkitekturën e mbrojtjes evropiane. Ministri Vengu shprehu gatishmërinë e Shqipërisë për të shtuar kontributin për sigurinë e kontinentit, duke rritur shpenzimet dhe investimet në mbrojtje.

★★★★★



KAMPUSI I RI I AFA

Kampusi i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura, i cili po ndërtohet sipas modelit të një prej akademive më të mira në SHBA, West Point, është drejt finalizimit të fazës së parë të projektit. Akademia e re do të ketë si fillim 300 studentë. Kryeministri Edi Rama, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Pirro Vengu, panë nga afër punimet në këtë kantier.

★★★★★

mod.gov.al

MM



STËRVITJE E PËRBASHKËT SHQIPËRI - SHBA

Efektivë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ushtarët dhe aviatorët e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit kanë zhvilluar një stërvitje të përbashkët. E pranishme në këtë stërvitje ishte edhe e ngarkuara me punë e Ambasadës së SHBA, Van Horn, e cila vëzhgoi ekipet tona duke pilotuar dronët dhe duke u trajnuar me kompaninë e mortajave të FARSH.

★★★★★

mod.gov.al

MM



80-VJETORI I THEMELIT TË SHKOLLËS USHTARAKE “SKËNDERBEJ”

80-vjetori i themelimit të ish-Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” mbledhi në një aktivitet ish-nxënës, pedagogë dhe drejtues të ish-Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”, por edhe oficerë dhe përfaqësues të Forcave të Armatosura. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i pranishëm në aktivitet, nënvizoi vlerat që Shkolla “Skënderbej” ka dhënë për arsimimin ushtarak shqiptar dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura.

★★★★★



USHTARAKU I LARTË KROAT NË TIRANË

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, priti në një takim kortezie shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjenerallejtënant Tihomir Kundid. Ministri dhe ushtaraku i lartë kroat diskutuan për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes. Më herët, gjenerallejtënant Tihomir Kundid u prit edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji.

★★★★★

mod.gov.al

MM



KONFERENCA E XHENIOS DHE LOGJISTIKËS NË VARSHAVË

Nga 24-28 mars, ekipi i Komandës Mbështetëse, i kryesuar nga gjeneral brigade Aleksandër Pando, mori pjesë në Konferencën e 11-të të Xhenios dhe Logjistikës në Varshavë. Ky event mbledhi përfaqësues ushtarakë dhe kompani të fushës për të diskutuar zhvillimet më të fundit teknologjike dhe operacionale. Ekipi shqiptar prezantoi temën “Modernizimi i kapaciteteve xheniere dhe EOD të FARSH”, duke ndarë eksperiencat dhe vizionin për përmirësimin e kapaciteteve ushtarake.

★★★★★

mod.gov.al



STËRVITJE ME ANIJEN GJERMANE

Efektivët e anijes Butrinti të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, pjesë e misionit të NATO-s Sea Guardian në Detin Egje, zhvilluan një stërvitje të përbashkët me anijen gjermane FGS Planet A1437. Gjatë stërvitjes në ujërat ndërkombëtare, u testuan aftësitë operacionale dhe u zhvilluan skenarë për rritjen e jetëgjatësisë së anijes, përfshirë menaxhimin e emergjencave si përmbytja dhe zjarri në bord.

★★★★★

mod.gov.al

MM



DY URA TË REJA “BAILEY”

Forcat xheniere, pjesë e Forcave të Armatosura, kanë përfunduar me sukses ndërtimin e dy urave tip “Bailey”, duke përmbushur nevojat e komunitetit në dy zona të ndryshme të vendit. Ura në lagjen Klos, në fshatin Fan, të Mirditës do t’u shërbejë rreth 600 banorëve të zonës. Ndërsa ura në lagjen Caraj, Perlat i Epërm, lidh rreth 450 banorë.

★★★★★

mod.gov.al

MM

ZËVENDËSMINISTRJA ABRAZHDA VIZITON TRUPAT E KFOR-it

Zëvendësministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, vizitoi Pejën, ku takoi efektivet e Forcës Tokësore që shërbejnë në misionin e KFOR-it, të drejtuar nga NATO. Ajo zhvilloi një takim edhe me komandantin e bazës, kolonel Francesco Errico, të cilin e falënderoi për leadershipin dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj kontingjenteve shqiptare me mision në KFOR, në Pejë, Kosovë.

★★★★★



PANAIRI “WORK & STUDY”

Në Dibër, Mat, Kukës, Shkodër, Lezhë, Kavajë, Berat, Durrës, Gramsh, Krujë, Sarandë, Librazhd, Elbasan, Fier, Lushnjë, Korçë, Pogradec dhe Vlorë u zhvillua panairi “Work & Study”, një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që kërkojnë mundësi studimi dhe punësimi. Gjatë aktiviteteteve, Akademia e Forcave të Armatosura dhe Qendra e Personelit të Rekrutimit prezantuan programet e studimit dhe mundësitë e punësimit, duke ofruar një rrugë të shkëlqyer për ata që janë të interesuar për një karrierë me disiplinë, sfida dhe mundësi zhvillimi.

★★★★★

mod.gov.al

MM




“BUTRINTI” SHPËTON EMIGRANTËT NË EGJE

Gjatë patrullimit në Detin Egje, anija “Butrinti” gjatë kësaj jave realizoi dy operacione shpëtimi (SAR), duke u ardhur në ndihmë dy gomoneve: njëra me 32 emigrantë nga Afganistani, e nisur nga Çeşme me destinacion ishullin Chios, dhe tjetra me 36 emigrantë nga Lindja e Mesme me të njëjtin destinacion.

★★★★★

mod.gov.al





SHQIPËRIA, PJESË E “MILITARY ERASMUS”

Shqipëria tashmë është pjesë e programit “Military Erasmus”. Ky program do t’u mundësojë së shpejti kadetëve të Forcave të Armatosura të formohen në më shumë se 10 shkolla ushtarake të vendeve të Bashkimit Evropian.

★★★★★

mod.gov.al

MM